



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:191250

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589419

KPPP.nr. 1432/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit DLD Group Sh.p.k., me nr. unik identifikues 810841636, me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian”, nr. 25, Pejton, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdullah Hoti, avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me adresë rr. “UÇK”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 609/23 të datës 24.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 18.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr. 609/23 i datës 24.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 24.08.2023 ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 609/23 me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit: faturë nr. 2022/0005 të datës 15.04.2022, duke urdhëruar debitorin që t’i paguajë kreditorit borxhin në shumë prej 1,875.00 EUR (njëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë euro), shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim në vlerë prej 104.00 EUR, dhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 104.00 EUR, si dhe shpenzime të tjera të cilat mund të rrjedhin gjatë procedurës. E të gjitha këto kërkesa të cekura më lartë të paguhen me kamatë prej 8% në pajtim me LMD, që nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarimit me arsyetimin se urdhri për përmbarim i lëshuar nga përmbaruesi privat është i pabazuar, si i tillë është i palejuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se i njëjti nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe se provat të cilat i janë bashkëngjitur propozimit nuk janë dokumente të besueshme sipas LPP-së, pasi që fatura e bashkëngjitur është vetëm kopje dhe pa konstatim dhe e cila nuk i plotëson kushtet esenciale për faturë të paraparë me nenin 22 lidhur me nenin 29 të LPP-së. Andaj i ka propozuar Gjykatës që ta aprovojë prapësimin e debitorit dhe ta abrogojë Urdhrin Përmbarimor P.nr. 609/23 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu.

Kreditore, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit me arsyetimin se i njëjti nuk është në pajtueshmëri me nenin 71 dhe paragrafët tjerë të këtij neni të LPP-së, dhe se fatura e cila është objekti i këtij propozimi për përmbarim është e rregullt, e pranuar, nënshkruar, me datë të lëshimit, si dhe ka vlerën e detyrimit të cilin duhet ta përmbushë debitori. Po ashtu ka theksuar se provat tjera të cilat i ka bashkëngjitur debitori nuk janë relevante, nuk dëshmojnë asgjë dhe vetëm se e zvarritin procedurën. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të mbetet i njëjti dhe i pandryshuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – fatura nr. 2022/0005 e datës 15.04.2022 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është

pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori. Deri tek ky konstatim, gjykata erdhi pasi që fatura e lartcekur nuk përmban vulën e pranimit nga zyra e pranimit të shkresave të debitorit Komuna e Prishtinës si institucion publik, ndërsa kreditori nuk është ofruar asnjë dokument mbështetës nga e cila do mund të dëshmohej se debitori është njoftuar me faturën kontestuese dhe të njëjtën e ka pranuar pa kundërshtim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1432/23, datë 18.04.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.